# RELACION

## PËR

## "MIRATIMIN E RREGULLORES SË FINANCIMIT TË PROJEKTEVE KULTURORE, ARTISTIKE"

Bazuar në nenin 25 të Ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, një nga funksionet kryesore të bashkive është dhe organizimi i aktiviteteve kulturore me qëllim promovimin e identitetit lokal, organizimin e aktiviteteve çlodhëse e argëtuese, për komunitetin dhe jo vetëm.

Me qëllim financimin e projekeve të ndryshme kulturore dhe artistike që paraqiten nga subjekte të ndryshme që shprehin interesim dhe kanë për objekt të veprimtarisë të tyre artin, kulturën Bashkia ka vendosur të financojë projektet që do të përdoret për këtë qëllim.

Në këto kushte mendojmë të miratojmë një rregullore e cila ka për qëllim mbeshtetjen e projekteve që paraqiten nga persona fizik dhe subjekte të ndryshme që kanë për objekt të veprimtarisë të tyre artin dhe kulturën, projekte që kontribojnë në promovimin e vlerave artistike, kulturore të qytetit dhe jo vetëm.

Sa më lart, në mbështetje të nenit 8 pika 2, 9/b, neni 25 pikat 2 dhe 4; nenit 64, të Ligjit nr.139/2015 datë. 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Kodit të Procedurave Administrative, Ligjit nr. 10352, datë 18.11.2010 "Për Artin dhe Kulturën"(i ndryshuar) neni 28/29; vendimit të Këshillit të Ministrave nr 150, datë 3.04.1993, "Për financimin e projekteve kulturore, artistike dhe sportive" (i ndryshuar); VKB nr. 167 dt 29.12.2023 që ka miratuar "Buxhetin vjetor 2024 dhe PBA

2024-2026 të Bashkisë Korçë propozojmë Këshillit Bashkiak të miratojë rregulloren bashkangjitur këtij materiali.

Drejtore e Përgjithshme Juridike dhe MBNJ

Anxhela Qeramixhi (Dishnica)

Drejtore e Qëndrës të Artit dhe Kulturës

Zamira Kita

Drejtore e Përgjithshme e Financës, Buxhetit dhe MFK

Valbona Ziko

KRYETAR I BASHKISË
Sotiraq Filo

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇË

QËNDRA E ARTIT DHE KULTURËS

P/VENDIM
NR. __________Datë_____/_____/2024

PËR
"MIRATIMIN E RREGULLORES SË FINANCIMIT TË PROJEKTEVE KULTURORE, ARTISTIKE"

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, 9/b, neni 25 pikat 2 dhe 4; nenit 54/k, të Ligjit nr.139/2015 datë. 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" I ndryshuar, Kodit të Procedurave Administrative, Ligjit nr.10352, datë 18.11.2010 "Për Artin dhe Kulturën"(i ndryshuar) neni 28/29; Ligji 68/ 2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" i ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr 150, datë 3.04.1993, "Për financimin e projekteve kulturore, artistike dhe sportive" (i ndryshuar); VKB nr. 167 dt 29.12.2023 që ka miratuar "Buxhetin vjetor 2024 dhe PBA 2024-2026 të Bashkisë Korçë dhe mbas diskutimeve të Këshilltarëve

VENDOSI:

1.Miratimin e rregullores së financimit të projekteve kulturore, artistike sipas teksit bashkangjitur.

2.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet, Qëndra e Artit dhe Kulturës.

5 Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore").

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Eva NAÇI

KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK

ANA VERUSHI

Miratuar me ________vota
Vota Pro__________
Vota Kundër_______
Vota Abstenim_________
Zbardhur më datë_________

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME JURIDIKE DHE E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

# REGULLORE

# PËR "FINANCIMIN E PROJEKTEVE KULTURORE, ARTISTIKE"

Bazuar në nenin 8 pika 2, 9/b, neni 25 pikat 2 dhe 4; nenit 54/k, të Ligjit nr.139/2015 datë. 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" I ndryshuar, Kodit të Procedurave Administrative, Ligjit nr.10352, datë 18.11.2010 "Për Artin dhe Kulturën"(i ndryshuar) neni 28/29; Ligji 68/ 2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" i ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr 150, datë 3.04.1993, "Për financimin e projekteve kulturore, artistike dhe sportive" (i ndryshuar); VKB nr. 167 dt 29.12.2023 që ka miratuar "Buxhetin vjetor 2024 dhe PBA 2024-2026 të Bashkisë Korçë, propozojmë miratimin e rregullorës si më poshtë:

Në kuptim të kësaj rregullore do të quhet:

1. Projekt kulturor – artistik, çdo aktivitet që zhvillon vlera për artin, kulturën, turizmin etj.
2. Mbështetja e Bashkisë Korçë për projekte artistike – kulturore, të paraqitura nga persona fizike e juridikë privat, vendas dhe të huaj si dhe shtetas shqiptarë të fushës së artit dhe kulturës, që kontribojnë në promovimin e vlerave artistike, kulturore, për këto fusha jepen në formën:
   a) me ambiente që administrohen nga Bashkia Korçë, ku zhvillohen aktivitete, si salla për shfaqe, ekspozita, panaire etj
   b) Në mjete financiare, në formën e financimit.
3. Mbështetja financiare do të kryhet në përputhje me fondet e përcaktuara për këtë qëllim nga Bashkia Korçë sipas buxhetit të miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak.

4. Bashkia Korçë do të ketë prioritet për mbështetien e projekteve të cilat janë të mbështetura ose janë pjesë e programeve të ndryshme kuiturore dhe me gjerë të Komunitetit Europian.

Adresa: Kodi Postar 7001, Lagji 12, Blv "Shen Gjergji", nr. 12, Tel : +35582243353, email:info@bashkiakorce.gov.al

5. Bashkëngjitur projektit aplikanti duhet të paraqesë pranë Bashkisë Korçë:

Për personat fizikë dhe juridikë kërkohen këto dokumenta:

Për personat fizikë dokumentacioni si më poshtë, por nuk kërkohen dokumentat që vërtetojnë formën juridike të aplikuesit, kopje e Vendimit të Gjykatës dhe liçenca të noterizuara.

## *DOKUMENTAT QË DUHET TË DORËZOHEN NË MOMENTIN E APLIKIMIT TË PROJEKTIT.*

a) Formulari i aplikimit pjesë e kësaj rregullore;

b) Kërkesa për mbështetje finaciare, e protokolluar në QAK;

c) Projekti artistik - kulturor, i ndërtuar mbi bazën e të gjitha pikave të përcaktuara në formatin e Aplikimit.

d) Vendimi i Gjykatës, Statuti i Shoqatës/Shoqërisë, Akti i themelimit, NIPT. (kopjet duhet të jenë të noterizuara.)

e) Vërtetim nga Gjykata që Shoqata, Fondacioni, shoqëria nuk është në proces falimentimi apo likujdimi.

f) Numrii Llogarisë Bankare në të cilin do të bëhet derdhja e fondeve të kërkuara. (IBAN -lek)

g) Preventivi total i detajuar në të gjithë zërat e tij, në krah të jenë shënuar donatorët përkatës.

h) Preventivi për zërat që janë dhënë nga Bashkia. (Preventivi duhet të jetë i firmosur dhe i vulosur nga aplikuesi. Ky preventiv mbetet i diskutueshëm nga Bordi Artistik i Bashkisë Korçë)

i) Dy rekomandime të lëshuara nga personalitete të shquara sipas fushës që mbulon projekti.

a. -Tre rekomandime nese subjekti aplikues është individ.

j) Deklarata mbi të ardhurat e projekit, nëse ka, si do të përdoren këto të ardhura.

k) Fotokopje të kartës së indentitetit ose pashaportës të aplikantit.

a.- Në rast se aplikimi bëhet nga një individ në vend të pikave d) e) zëvendësohen me një biografi personale, CV dhe të akivitetit artistik).

## *PROCEDURAT E GJYKIMIT DHE MIRATIMIT PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT*

a) Paraqitia e dokumentacionit të plotë të kërkuar sipas detajimit si më sipër.

b) Qendra e Artit dhe Kulturës mbasi gjykon, vlerëson përputhjen me objektivat dhe programin e Bashkisë. projektet e paraqitura së bashku me preventivat e tyre, i kalon pér miratim në Bordin Artistik

c) Bordi Artistik, i miratuar nga Käshilli i Bashkisë Korçë dhe përbëhet nga 7 anëtarë, të cilët përfaqësojnë fusha të ndryshme.

d) Afai maksimal i shqyrtimit të projektit mbas dorëzimit në QAK është 15 ditë.

e) Mbas miraimit të projektit nga Bordi Artistik, ky i fundit i paraqet relacion drejtorit të QAK me propozimin për fituesin. Drejtori i QAK shpall fituesin me vendim dhe përpilon, nënshkruan akt-marrëveshjen me shoqatën/ fondacionin, personin fizik dhe juridik duke përcaktuar edhe fondet që do të përdoren për këto projekte.

f)Pas mbarimit të aktivitetit shoqata, fondacioni, personi fizik dhe juridik dorëzon dokumentat në QAK lidhur me shpenzimet e kryera dhe organizimin e aktivitetit dhe një kopje e gjithë dokumentacionit ia kalon Drejtorisë së Financës në QAK e cila kryen financimin e projektit.

## *DOKUMENTACIONI QË DUHET TË DORËZOHET PAS KRYERJES SË AKTIVITETIT NGA FIIUESI*

a) Në rastin kur është shoqatë ose person juridik duhet të lëshojë një fautrë për QAK, për shumën që është mbështetur.

b) Situacionin (duher të jetë i firnosur dhe i vulosur nga apikuesi, të ketë datë dhe të jetë i rakorduar me faturat për shpenzimet e kryera).

c) Raport financiar me të gjithë donatorët (situacioni faktik i preventivit total).

d) Faturat, të cilat duhet të jenë në formën e duhur ligjore referuar legjislacionit tatimor në fuqi.

e) Kontratat me personat që kanë lëshuar faturat.

f) Fotokopje e liçencës e atij që ka lëshuar faturën.

g) Fotokopje pashaportë/kartë identiteti.

h) Vërtetimet nga donatorët, nëse ka.

i) Relacion mbi zhvillimin e aktivitetit dhe impakti i tij në pubtik, dhe marrjen në dorëzim të projektit.

j) 10 foto, si dhe materiale të tjera, dokumentare mbi zihvillimin e aktivitetit.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇË
QËNDRA E ARTIT DHE KULTURËS

# FORMULAR APLIKIMI

| PËR MBËSHTETJE TË PJESSHME APO TË PLOTË FINANCIARE |
|---|
| Plotësoni me kujdes këtë formular, sipas të gjitha udhëzimeve, duke i bashkangjitur edhe projektin e detajuar sipas sqarimeve në faqen e fundit. |

| | |
|---|---|
| Data e ardhjes së aplikimit | |
| 1.Titulli i Projektit_________________<br>2.Fusha e Projektit: Art ☐ Kulturë ☐ | Aprovohet po ☐<br>jo ☐ |
| 3.Aplikanti:____________________________ | |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇË
QËNDRA E ARTIT DHE KULTURËS

| | |
|---|---|
| 4.Drejtuesi i Projektit:<br>Emri:______________Mbiemri:__________________<br><br>Adresa________________________<br>Tel:__________________________<br><br>Adresa e punës:____________________<br>Tel:______________________________ | Shënime |
| 5.Zerat e shpenzimeve që kërkohen të mbështeten nga Bashkia<br><br>5/1:______________________________shuma_____________________lekë<br>5/2:______________________________shuma_____________________lekë<br>5/3:______________________________shuma_____________________lekë<br>5/4:______________________________shuma_____________________lekë<br>5/5:______________________________shuma_____________________lekë<br>5/6:______________________________shuma_____________________lekë<br>5/7:______________________________shuma_____________________lekë<br>5/8:______________________________shuma_____________________lekë | Specialisti<br><br>Drejtori |

6.Donatorë të tjerë të projektit tuaj. Zëri I shpenzimeve të mbuluara. Shuma e dhuruar:

6/1:Donatori__________________zëri I shpenzimeve_______________shuma_____________

6/2:Donatori__________________zëri I shpenzimeve_______________shuma_____________

6/3:Donatori__________________zëri I shpenzimeve_______________shuma_____________

6/4:Donatori__________________zëri I shpenzimeve_______________shuma_____________

6/5:Donatori__________________zëri I shpenzimeve_______________shuma_____________

6/6:Donatori__________________zëri I shpenzimeve_______________shuma______________

6/7:Donatori__________________zëri I shpenzimeve_______________shuma______________

Buxheti total I projektit tuaj:______________________________________________________

7.Objekti dhe qëllimi I projektit:

_____________________________________________________________________________________

_____________________________________________________________________________________

_____________________________________________________________________________________

8.Tregoni me saktësi mbështetjen nga Bashkia dy vitet e fundit.

(Projektin, shumën, datën)

8/1:Projekti_____________________________shuma________________data_______________

8/2:Projekti_____________________________shuma________________data_______________

8/3:Projekti_____________________________shuma________________data_______________

8/4:Projekti_____________________________shuma________________data_______________

8/5:Projekti_____________________________shuma________________data_______________

8/6:Projekti_____________________________shuma________________data_______________

9.Bashkëngjitur kësaj Formë-Aplikimi do të paraqisni projektin I cili duhet të jetë hartuar mbi pikat e mëposhtme:

- Titulli i projektit. Emri i Aplikuesit
- Adresa e plotë e Aplikantit
- Qëllimi i Projektit
- Përshkrimi i Projektit
- Cilësoni përfituesit direkt dhe indirekt të projektit tuaj. Përdorni mundësisht statistika për interesin e publikut ndaj projektit tuaj.
- Përshkruani të renë që sjell projekti juaj në një projekt i ngjashëm me të.
- Ekipi dhe burimet njerëzore: specifikoni emrat, vendin e punës dhe funksionin e secilit pjesëtar të ekipit që do të punojë në këtë projekt.
- Specifikoni burimet dytësore për projektin tuaj në të holla apo shërbime. Si dhe kontratat apo miratimet në parim të të dytëve për ndihmë ndaj projektit tuaj.
- Paraqisni formën juridike të grupimit tuaj.
- Tregoni grafikun kohor të realizimit të projektit tuaj: Fillimi-kohëzgjatje-mbarim
- Ndërtoni dosjen e detajuar të buxhetit të projektit tuaj. Pagesat e sakta të ekipit të këtij projekti si dhe përdorimin e të ardhurave nga ky aktivitet nëse ka të tilla.
- Bashkangjitni projektit dy referenca nga personalitete të fushës së projektit tuaj.

Deklaratë e aplikuesit

Unë,________________________________________________

Në cilësinë e aplikantit dhe njëkohësisht të drejtuesit të projektit të paraqitur, deklaroj se të gjitha materialet dhe dokumentacionet e sipërshkruara dhe të bashkangjitura janë të vërteta.

Në rast financimi të këtij projekti pranoj të gjitha kushtet e kontratës që do të lidhet me Bashkinë, për zhvillimin e projektit.

Emri______________________________data______________________

Nënshkrimi dhe /ose vula e
aplikuesit________________________________________________

Kjo formë-aplikimi së bashku me projektin të paraqiten në

PROTOKOLL